



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1275/ 6 prot

Datë 24.05.2024

V E N D I M
Nr. 564/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.05.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-02161-04-22-2024, me objekt: “*Blerje cakulli*” me fond limit 13,299,360 (*trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 09.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kavajë.
Adresa: Bulevardi “Josif Budo”, Kavajë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Sark” SHPK me NIPT K52531415H, me adresa: Rruga “Skëndërbeu” Lagjja “8 Shkurti”, Fier.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.04.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me REF-02161-04-22-2024 me objekt “*Blerje çakulli*”, me fond limit 13,299,360 (*trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 09.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

II.2. Në datën 09.05.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se në datën 17.05.2024, autoriteti kontraktor ka vlerësuar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH).

II.4. Në datën 17.05.2024, operatori ekonomik “*Sark*” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

SARK SHPK Oferta juaj eshte refuzuar per arsyet e meposhtme:

1. Nga verifikimi i kryer ne dokumentet e tenderit te paraqitura ne SPE, operatori ekonomik *Tabi Construction* nuk ka paraqitur origjinale ose kopje te noterizuar Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar per bilancin e vitit 2023 te ngarkuar ne SPE. Dokumenti i paraqitur nuk eshte origjinal ose kopje e noterizuar, sic kerkohet ne DST.

2. Nga verifikimi i kryer per dokumentet e tenderit te paraqitura ne SPE OE nuk permbush piken 2.3.3 te DST nuk eshte i pajisur me certifikate ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001 per mallrat objekt - prokurimi. Ne fushat e aktivitetit per te cilat eshte certifikuar nuk perfshihen produktin objekt - prokurimi.

II.5. Në datën 22.05.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër 1275 prot e operatorit ekonomik “Sark” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1275/2 date 23.05.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Sark” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.7. Me shkresën nr. 2841/1 prot, datë 22.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 1275/3 prot, datë 24.05.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion, ku thuhet shprehimisht si vijon:

“[...] Autoriteti Bashkia Kavajë ka në proces procedurën e prokurimit në sistemin SPE si më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur

Numri i referencës së procedurës/Lotit: REF-02161-04-22-2024

Objekti i kontratës/Marrveshjes Kuadër: Blerje cakulli

Fondi Limit: 13,299,360 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatim e saj: 8 muaj

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 09.05.2024 Ora: 10:00

Në lidhje me këtë procedurë ju vëmë në dijeni se kjo procedurë është hapur në datën dhe orën e caktuar nga personat përgjegjës.

Më datë 17.05.2024 ka përfunduar vlerësimi i operatorëve ekonomik në SPE nga anëtarët e Komisionit të Vlersimit të Ofertave.

Në datën 22.05.2024 pranë AK është paraqitur një ankesë nga OE “Sark” shpk në lidhje me vlerësimin dhe skualifikimin e këtij operatori ekonomik. Ankesa është publikuar edhe në rregjistrin elektronik të ankesave të KPP.

Bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 pika 6 shprehimisht thuhet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin

e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ju bëjmë me dije se AK aktualisht është në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit kualifikuar i pari të dorëzuara më datë 21.05.2024 sipas kërkesës tonë më datë 17.05.2024 dhe nuk ka publikuar akoma në SPE Formularin e Njoftimit të Fituesit Paraparak.

Referuar përcaktimeve në nenin 110 të :igjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” afatet e ankimit fillojnë pas publikimit të njoftimit të fituesit në SPE për këtë arsye ankesa e paraqitur nga OE “Sark” shpk është jashtë afateve të ankimit”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1.1. Në datën 23.04.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me REF-02161-04-22-2024 me objekt “*Blerje çakulli*”, me fond limit 13,299,360 (*trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 09.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

III.1.2. Në datën 09.05.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se në datën 17.05.2024, autoriteti kontraktor ka vlerësuar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH).

III.1.4. Në datën 17.05.2024, operatori ekonomik “Sark” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

SARK SHPK Oferta juaj eshte refuzuar per arsyet e meposhtme:

1. Nga verifikimi i kryer ne dokumentet e tenderit te paraqitura ne SPE, operatori ekonomik Tabi Construction nuk ka paraqitur origjinale ose kopje te noterizuar Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar per bilancin e vitit 2023 te ngarkuar ne SPE. Dokumenti i paraqitur nuk eshte origjinal ose kopje e noterizuar, sic kerkohet ne DST.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

2. Nga verifikimi i kryer per dokumentet e tenderit te paraqitura ne SPE OE nuk permbush piken 2.3.3 te DST nuk eshte i pajisur me certificate ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001 per mallrat objekt prokurimi. Ne fushat e aktivitetit per te cilat eshte certifikuar nuk perfshihen produktin objekt prokurim.

III.1.5. Në datën 22.05.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër 1275 prot e operatorit ekonomik “Sark” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1275/2 date 23.05.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Sark” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

III.1.7. Me shkresën nr. 2841/1 prot, datë 22.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 1275/3 prot, datë 24.05.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik informacion, ku thuhet shprehimisht si vijon:

“[...] Autoriteti Bashkia Kavajë ka në proces procedurën e prokurimit në sistemin SPE si më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur

Numri i referencës së procedurës/Lotit: REF-02161-04-22-2024

Objekti i kontratës/Marrveshjes Kuadër: Blerje cakulli

Fondi Limit: 13,299,360 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatim e saj: 8 muaj

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 09.05.2024 Ora: 10:00

Në lidhje me këtë procedurë ju vëmë në dijeni se kjo procedurë është hapur në datën dhe orën e caktuar nga personat përgjegjës.

Më datë 17.05.2024 ka përfunduar vlerësimi i operatorëve ekonomikë në SPE nga anëtarët e Komisionit të Vlersimit të Ofertave.

Në datën 22.05.2024 pranë AK është paraqitur një ankesë nga OE “Sark” SHPK në lidhje me vlerësimin dhe skualifikimin e këtij operatori ekonomik. Ankesa është publikuar edhe në regjistrin elektronik të ankesave të KPP.

Bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 pika 6 shprehimisht thuhet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në

rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ju bëjmë me dije se AK aktualisht është në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit kualifikuar i pari të dorëzuara më datë 21.05.2024 sipas kërkesës tonë më datë 17.05.2024 dhe nuk ka publikuar akoma në SPE Formularin e Njoftimit të Fituesit Paraprak.

Referuar përcaktimeve në nenin 110 të :igjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” afatet e ankimit fillojnë pas publikimit të njoftimit të fituesit në SPE për këtë arsye ankesa e paraqitur nga OE “Sark” SHPK është jashtë afateve të ankimit”.

III.1.8. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit, për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

III.1.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

III.1.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në rastin konkret, referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar në SPE njoftimi i fituesit, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ndërkohë që operatori ekonomik “Sark” SHPK ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit Prokurimit Publik më datë 22.05.2024.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të **ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”**,

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit (anulimit) dhe përfundon në ditën e 7-të. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e administruar në datën 22.05.2024, me nr. 1275 protokoll, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se:

“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e tij nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshur, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në

një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sark” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me REF-02161-04-22-2024, me objekt “Blerje cakulli”, me fond limit 13,299,360 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 09.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

